

7. Leja e lindjes,lindja,kontraceptimi

Qytetarja e huaj në shtatzani që gjëndet në Itali edhe në mënyrë jo të rregullt nuk mund ti bëhet ekspuls deri sa fëmija të mbush 6 muaj.

Gruas shtatzan i lëshohet nga Questura një leje qëndrimi për kura mjekësore.

Në Itali,vizitat dhe mjekimi në shtatzani janë falas për të gjitha gratë(nuk paguhet ticket).

Edhe gratë e huaja jo në rregull me lejen e qëndrimit kanë të drejtën e ndjekjes së shtatzanisë falas.

Qytetaret jo komunitare që kanë lejen e qëndrimit CE për punësi ose për autorizime për punësi,leje qëndrim CE për qëndrime më të gjata(ish Carta di Soggiorno),leje qëndrimi CE për mbrojtje apo në rast të refugjatëve politik,akoma e vlefshëme,kanë të drejtën edhe të një bonus për lindje e cila jepet nga komunat.

Të gjitha qytetaret e huaja që janë në pritje të lëshimit të lejes së qëndrimit CE duhet të paraqesin brënda 6 muajsh nga lindja e fëmijës kërkesën për bonusin e lindjes komunës ku është rezidente bashkangjitur faturën që vërteton kërkesën për lejen e qëndrimit.

Kanë të drejtë për bonusin e lindjes edhe qytetaret jo komunitare por që kanë familjar një qytetar të Bashkimit Europian (ose italianë),me leje qëndrimi pesë vjecare,si edhe qytetaret me familjarë me kartën e qëndrimit të përhershme por që nuk kanë nënshtetësi në një shtet pjesë të Bashkimit Europian.

Për “familjarë” nënkuptohet për bashkëshort,të afërmit e ngushtë në moshën më të vogël se 21 vjecare ose që janë përsipër dhe ata të bashkëshortit;të afërm të ngushtë ose që janë përsipër bashkëshortit.

Sipas ligjit Italian(Ligji 194)mund të ndërpritet shtatëzania brënda 90 ditëve nga ngjizja.

Mbas 90 ditësh,ndërpritet shtatëzania vetëm nëse nëna e ardhme është në rrezik të lartë për jetën(për shkak të shtatëzanisë)ose nëse fëmija që duhet të lind ka keqformime të rënda konsultorit.

Konsultori

Konsultori është një shërbim tutelimi të shëndetit dhe cilësisë së jetës së gruas,të fëmijës dhe të familjes i cila ofron mirpritjeje,asistence dhe mjekim falas dhe të drejtpërdrejtë,pa nënshkrime mjekësore,mbi temat e mëposhtme:

- riprodhim me përgjegjshmëri,përfshirë edhe rrugëzimin për kontrceptimin falas;
- rrugëzimi drejt lindjes(konsulta para-ngjizjeje,shtatëzani,puerproi);
- sterilitet dhe vështirësi riprodhuese(nivel i parë)
- Ndrëprerje të vullnetshme të shtatzanisë;
- parashikim të kancerit në qafën e mitrës;
- parashikim të sëmundjeve të trashëgueshme nga marrdhëniet seksuale
- rrugëzimi drejt monopauzës
- mbështetje në prindërim biologjik,kujdestarisë ose adoptimit;
- relata të vështira familjare,probleme në çift,vështirësi afektive;
- aktivitete ndërmjetësuese familjare në raste ndarjeje apo divorci;
- dhunë apo keqtrajttime me aktivizimin e rrugëzimit të mbështetjes

Kush punon

- Mamija
- Gjinekologu
- Psikologu
- Asistenti Social

Si bëhesh pjesë

- Duke u paraqitur në konsultor
- Duke telefonuar/ose me email

- Duke prenontuar CUP

Në **Firenze** ,ekzistojnë **Konsultorë Emigrantë** të dedikuar për gratë dhe fëmijë të huaj të regjistruar në SSN ose jo(mbartës të STP ose ENI),me praninë edhe të një mediatori lingvistik e kultural.

Mund ti drejtohesh konsultoreve emigrantë edhe pa pasur lejen e qëndrimit(me kartën STP)

Adresa e konsultoreve në Firenze në linkun më poshtë:

<https://www.uslcentro.toscana.it/index.php/diagnosi-e-cura/619-consultorio/10418-consultori>

Kliko mbi “Zona Firenze”

Dokumente që duhen prezantuar tek konsultori:

Asistenca për gratë shtatëzana dhe të foshnjës është falas për të gjitha gratë,italiane apo të huaja,me lejen e qëndrimit të rregullt apo pa dokumenta.

Qytetaret e huaja të pajisura me lejen e qëndrimit ,kanë të drejtë të regjistrohen në shërbimin shëndetësor nacional(SSN)

Qytetaret jashtë BE pa lejen e qëndrimit kanë të drejtën e përjashtimit të pagesës së ticket për cdo shqyrtim dhe për cdo vizitë tek mjeku specialist kur kanë të bëjnë më shtatëzaninë,lindjen.

Është e nevojshme karta STP(I huaj Momentalisht i Pranishëm)

Për informacione të më tejshme mbi konsultoret <https://icare.sanita.toscana.it/>